



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.130/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Nenad Lazić dhe Afijete Zogaj-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë – dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterve të kandidatit të tyre në pronë private, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.130/2019 e datës 29.09.2019, e paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë – Dega në Komunën e Prizrenit.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2019, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 29 Shtator 2019, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi në shumë rrugë të Lagjes “Ortakoll” në Prizren, ku ka hasur në poster të kandidatit për deputet të këtij subjekti politik, të vendosura në pronë private. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka bërë shkelje të dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073. Me propozim që të pranohet e bazuar ankesa.

Në përgjigjën në ankesë, subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të datës 30.10.2019, thekson se paraqitësi i ankesës nuk e ka përcaktuar kohën e saktë të shkeljes, veprim i cili është kriter ligjor i përcaktuar në Rregullën nr.02/2015, Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 5 paragrafi 5.7 pika b). Me propozim për panelin që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës, vlerësoi se e njëjta është e pabazuar për këto arsye:

Paneli, vlerëson se pretendimet e ankuesit janë të pabazuar, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, siç pretendohet në ankesë sepse ankuesi nuk e ka ofruar asnjë dëshmi, se materiali propagandistik për promovimin e subjektit politik, gjatë fushatës zgjedhore është vendosur nëpër vetura siç shihen në fotografi që gjenden në shkresat e

lëndës, pa lejen e pronarëve të tyre, andaj pretendimet e ankuesit nga paneli vlerësohen të pa bazuar në ligj dhe të njëjta janë vlerësuar si të përgjithësuara se ato fletushka janë vendosur nëpër automjete pa lejen e pronarëve të tyre.

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografit e ofruar si prova materiale nga ankuesi për panelin janë të paqarta dhe nuk janë bindëse për te vendosur ndryshe në këtë rast. Përveç asaj se ankuesi nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi që materiali propagandistik për promovimin e subjektit politik, është vendosur pa lejen e pronarëve të tyre nëpër vetura, ankuesi ka dështuar të dëshmon edhe kur ka ndodhur shkelja pretenduar, duke e përfshirë datën e shkeljes, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar, siç kërkohet me nenin 5 paragrafi 7 pika b), i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 8 paragrafi 4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.130/2019 më datën 02.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi
nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.
4 të LZP-së.***